

Klementina Hysa

Bujtësit
ehotelit
të
vogël

BUSTËSIT E HOTELIT TË VOGËL • tregime • K. Hysa

8344-32
1199

tregime

344-32
499

Klementina Hysa

Bujtësit e hotelit
të vogël

tregime



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Dëbora në prill

Në atë qytet dëbora ishte një gjë e rrallë, e çuditshme, ndaj dhe e mirëpritur. Kështu edhe për Ketin. Hodhi sytë jashtë në oborr. Çdo gjë ishte e mbuluar me një vel të bardhë: pemët, pullazet e tarracat e shtëpive. Linda, e bija, qe ngritur më përpara dhe rrinte si e shtangur në verandë, duke parë dëborën. E pra, s'kishte rënë gjithë dimrit, kur ja, u kujtua në pranverë, në ditët e para të prillit. Keti mbylli perden e dritares dhe u ul në cep të divanit. Edhe atëherë, para njëzet vjetësh, kishte rënë dëborë në mes të pranverës, në prill. Po, e mbante mend mirë atë dëborë.

— Hajde shëtitim andej lart, përpjetë rru-gës së blireve, — i kishte thënë të fejuarit, kur u takuan pasdite. E di, kam një mendim, do të rrëshqasim! S'na sheh njeri, — vazhdoi e ngazëllyer dhe e tërhoqi pas vetes fort, me padurim, pa e lënë të thoshte gjysmë fjale. Ai

u bind. Do të shëtisnin në rrugën ku për herë të parë i qenë hapur njëri-tjetrit. S'kishin kaluar veçse pak ditë, po Ketit i dukeshin muaj. Ajo ishte rruga e tyre dhe Ketit i vinte paksa inat kur shihte ndonjë çift tjetër të vërtitej atyre anëve. Rruga duhej t'u përkiste vetëm atyre të dyve.

I zbritën urbanit në kilometrin 2 dhe bënë sikur morën rrugën përpjetë, drejt klubit, për t'iu përvjedhur vështrimit plot kërsëri të udhëtarëve që, gjer atëherë të përgjumur, sikur u gjallëruan. Keti e kishte parashikuar. Nuk donte aspak që dikush t'i hynte në intimitetin e saj. Prandaj njerëzit mudohej t'i gënjente me shpërfillje, me truke si ky që po bënte tani, që ata të vazhdonin të shihnin punën e vet, megjithëse nuk ishte e lehtë ta shikoje me indiferencë fytyrën e saj mituke e sidomos sytë gjithnjë të lëvizshëm e gjithë zjarr, që e tradhtonin për çdo gjë që do të bënte apo që mendonte. S'duhej ndonjë sy i stërvitur për ta zbiruar.

Pasi autobusi u zhduk, ata mbetën me botën e tyre dhe dëborën. Kthyen drejtimin dhe morën teposhtë rrugës. Asgjë s'pipëtinte, gjithçka ishte strukur në qetësi.

U kapën nga duart dhe zbritën në pikë të vrapit. Kur këmbët, prej vrullit, filluan të mos u urdhëroheshin, u bënë me krahë, u shtrënguan fort dhe e lanë veten të rrëshqitnin. Kjo ishte një lojë me rrezik. Keti nuk ishte mësuar me dëborë. Mund të shkisje nëpër ferra po të mos kishe pranë një krah të fortë. Ajo e mendonte këtë dhe buzëqeshte e ngrohur.

Shpejtësia ngadalësohej, por ata u jepnin kë-

mbëve prapë dhe prapë shtrëngonin duart; ajo nga frika mblidhej e tëra dhe mbyllte sytë.

Vrapin e ndalën pranë një porte të madhe prej druri. Në të dyja anët e rrugës ngriheshin vila dykatëshe, që formonin një lagje të vogël jashtë qytetit. Zotërit e tyre të dikurshëm duhej t'i kishin ngritur njëherësh. Tani aty banonin njerëz të thjeshtë e të mirë, frymëmarrja e të cilëve shkrihej me atë të qytetit. Këtu pikërisht u ndien dihatjet e para të tij. Prandaj ajo deshi të largohej ca më shpejt nga sytë e njerëzve, të mbeteshin vetëm.

U ngjitën përsëri, këtë radhë më këmbë. Ngjitja ishte pak e lodhshme. Megjithatë Keti nuk ecte, por vraponte, duke gulçuar nga pak. Nën kapuçin e ngrohtë mezi dallohej një fytyrë e vockël, me një hundë kaproçe të ngritur përpjetë. Nga goja i dilte avull dhe ajo ngrohte duart me të. Ata ngjiteshin të kapur për qafe dhe ecnin pa folur. Tek-tuk ndonjë udhëtar i vonuar ose makinë ua priste atë ëndërrim. Me të shpejtë ajo hiqte duart dhe merrte një shprehje indiferente. Por kjo shpleksje duarsh herë pas here, pse u qe tekur udhëtarëve të bridhnin në atë kohë, e mërziste, e nervozonte.

Në fund të fundit, nuk do të çante më kokën për askënd; pastaj edhe pak e binte nata.

Majtas zbriste një rrugë që të çonte në disa shtëpiza druri me çati shumë të pjerrura, të ngjashme me ndërtesat karakteristike të vendeve të ftohta veriore. Më tej rruga të shpinte në një fidanishte. Djathtas, rrugina tjetër të fuste në parkun e madh plot labirinte. Ajo i njihte gjithë këto vende me sy mbyllur. I kishin shkelur kaq herë pëllëmbë për pëllëmbë. Por sot i pëlqente vetëm një gjë: të rrëshqiste.

Më së fundi mbërritën prapë lart. Ja, përsëri

guri i kilometrit 2. Ata u ulën për t'u çlodhur e për të gdhendur emrat e tyre.

Kraf... u thye një degë e rënduar nga dëbora. Krëk... kra... kraa, zhurmoi një zog i madh, i zi e i shëmtuar. Ai i pa me habi dhe pastaj ngriti krahët e u largua me përtesë.

Dalëngadalë qielli i plumbtë filloi të fikej. Bredhat e parkut qëndronin hijerëndë si ca gjeneralë me spaleta të argjendta.

«Grinajd», dëgjoi prapa veshit. Ishte një emër i ri, i padëgjuar, por asaj se përse i pëlqeu aq shumë.

«Grinajd», dëgjoi përsëri dhe përsëri iu bë se e tha dikush në errësirë, për hapësirën. Atë e mori era, e çoi diku dhe e ktheu prapë.

— Grinajd, — kështu do të të thërres që sot e tutje, — i tha ai duke i shkuar dorën lehtë mbi sup. — Do të thotë sygjelbër. Të shkon tamam.

— Hajde të rrëshqasim, — dhe ajo e rrëmbëu pas vetes, pa i lënë kohë të thoshte gjë tjetër.

Përsëri rrëshqitën. Fiuqu...u fishkëllyen në veshë blirët anës rrugës, si për t'i nxitur. Përsëri vrapin e ndalën te porta.

— Edhe një dhe s'ka më, kjo është e fundit, — e luti ajo me përgjërëm.

Tani ishte errur plotësisht. Kësaj radhe rrëshqitën shumë ngadalë. Zëri s'i dilte, këmbët dhe duart s'i dukeshin të sajat, nuk i bindeshin. U ndalën përsëri te porta e madhe. Dëbora filloi të binte me flokë të mëdhenj, duke u rrahur fytyrat pa mëshirë. Tani sikur s'po i pëlqente më, madje po i dukej e mundimshme. I bëhej sikur duart ia shponin mijëra gjemba, ndërsa këmbët plumb të rënda s'dëgjonin të ecnin. Veshët e përflakur i çukitnin aq sa i vinte për të qarë. Ai

e futi te streha e portës dhe e mbuloi me trupin e madh, duke u munduar t'i shpinte gjymtyrët e rënduara.

Mbi buzët e mavijosura, të çara nga të ftoh-tët, ndjeu diçka të ngrohtë. Në fillim s'kuptoi, pastaj u spraps e frikësuar; kjo qe fare e papritur. Iu duk një gjë e çuditshme, e turpshme, dhe vuri gishtat mbi buzë, si për ta shlyer atë që ngjau, sikur donte t'i fshinte.

— Keti, çudi me ty, ti,.. vetë... s'e kuptoj, ti ke mbetur akoma fëmijë, — tha ai i fyer.

— Kam ngrirë, nuk e sheh si kam ngrirë? Uf, sa më dhembin duart. Hajde të ikim që këtej, dua të shkojmë në shtëpi, kush e dëgjon mamane. — Ajo u mbështet pas supit të tij dhe ai pothuaj e mbajti krahaqafë trupin e vogël të rënduar. Asaj po i shfaqeshin shenjat e para të ngrirjes. Ajo copë rrugë që i kishte mbetur deri në shtëpi, iu duk pa fund. Te dera u ndalën.

— Natën e mirë, — i tha ai, — dhe futu shpejt në dhomë të ngrohtë, por jo pranë sobës. Mundohu të shpihesh nga pak me fërkim.

Shpresonte krejt pa arsye t'i gjente të gjithë në gjumë. Filloi të kërkonte çelësin nën derë, kur ia hapi e ëma. Afshi i ngrohtë i kuzhinës e qëlloi me një furi gjilpërash që i vërshuan në enët e gjakut në të gjithë trupin, duke i shkaktuar dhembje të reja. I vinte të bërtiste, por e mbajti veten. Nëna s'duhej të merrte vesh ç'i kishte ndodhur. Kaluan çastet e para, më të vështirat, dhe për fat gjatë asaj kohe nëna s'qe aty, diçka përgatiste në kuzhinë. Tani gjilpërat filluan të rralloheshin. Keti rrinte e mpirë, i ngrinte zemra, i vinte turp. Si t'ia bënte që t'i shpëtonte vështrimit hetues, gjithë qortim, të së ëmës?

— Ha dhe bjer. Ora po vete dhjetë. — Fja-

lës së fundit i mëshoi qëllimisht. Keti u drodh. S'ktheu përgjigje. Ky qëndrim mund t'i dilte edhe për keq, e ëma mund të nxehej. Çdo nënë mund të nxehej. Ndërsa me nënën e saj ndodhte ndryshe. Ajo e merrte heshtjen si një lloj pendimi dhe Keti dinte të përfitonte nga kjo. Kështu edhe shpëtonte nga vvarjemendjet për të trilluar diçka bindëse. Por sonte ndiente më shumë frikë nga çdo ditë tjetër. Buzët i digjinin dhe sepse, për çudi, nëna vetëm aty e vështronte. E pushtuan të dridhura dhe filloi të hante me nxitim, si për të shlyer gjurmët e një mëkati. Dhembjet e shpirjes s'e linin rehat, nga ana tjetër e ëma... Oh, ç'torturë!

«Pse s'bie, pse s'shkon të flesh, po rri e më përgjon», i drejtonte asaj këtë pyetje të heshtur. Nëna, sikur t'ia kishte kuptuar mendimet, i tha një «natën e mirë», që asaj iu duk si mallkim.

Në shtratin e ngrohur nga vëllai i vogël nëntëvjeçar mendimet iu qetësuan. Pastaj qau siç qajnë fëmijët për një send të humbur. Qau për fëmijërinë.

Ishte e vërtetë që ajo ishte pak çapkëne dhe fliste me zë të lartë, por ishte dhe mjaft e prekshme, me shpërthime të papritura.

*

*

*

Dita e nesërme sillte hove të reja: pritjen, padurimin, gëzimin e takimit...

Para se të ndaheshin, harroheshin për orë të tëra te porta e shtëpisë, me biseda pa mbarim. Grindeshin, pajtoheshin në çast, kujtonin ndonjë mbetje qejfi diku të harruar, derisa më në fund

dilte se ajo ishte akoma fëmijë. Pastaj niste prapë ankthi i vonimit. I druhej sidomos së ëmës. Sa të lehtë e kishte gjumin, të shkretën!

Vinte veshin prapa derës e rrinte ashtu një copë herë që të përgjonte zhurmat nëpër shtëpi. Por jo, në dhomën e prindërve dëgjoheshin hapa të lehtë, që kuptoheshin nga rënkimet e dyshemësë prej dërrase, dhe kraf-krufi i çelësit i ngjante si një kërcënim.

— Prapë vonë? — Nëna ishte e shqetësuar, e zemëruar, madje tepër e revoltuar. E zinte nga krahu dhe e tërhiqte brenda. — Nesër ke punë me tët atë, po erdhe prapë vonë! — Këtu ajo e ulte zërin, që askush tjetër të mos dëgjonte. Në të vërtetë ishin vetëm ca qortime të vogla të mamasë. I thoshte nga merakun, se babai tanimë s'donte t'ia dinte! Ai kishte bërë çmos t'ia kthente mendjen. Jo se kishte gjë kundër djalit, përkundrazi. Kishte biseduar një herë me të dhe ishte ndarë me përshtypje të mira. Por ja, ishte mosha, shkolla e lartë e pambaruar.

Një herë, ama, nëna e kishte trembur vërtet.

— Prapë vonë, i kishte thënë me ton të qetë, por prerë. — Nesër, po më erdhe kështu, shko më mirë në shtëpi të tij...! — Kësaj radhe nëna dukej e zemëruar seriozisht. Kishte një fytyrë të përflakur. Nëna ishte tepër e mirë, por pak e trembur. Ketit i vinte të nxehej, i vinte për të qarë pse njerëzit, midis tyre edhe nëna e saj e mirë, mendonin gjëra që asaj s'i vinin kurrë ndër mend. Ajo hahej me veten, se nënës s'i kthente dot fjalë. Le që ku flitej me të për këto gjëra! Ato nuk kishin qenë kurrë të afërta, si shoqe. Vetëm mendimi se nëna merakosej për të, e bënte të skuqej. Pse njerëzit ishin ashtu? Ajo donte

të rrinte sa më shumë me atë, të bisedonte, të bridhte, të ulej në ndonjë rrëzë me diell në park, të vraponte dhe të mos dinte ç'bëhej rrotull. Ç'kishin njerëzit me hamendjet e tyre që e shqetësonin nënën, pse s'i linin ata të dy në punë-të vet? Këto donte t'ia thoshte nënës një herë e mirë, por, kur gjendej para saj, ajo i dukej e largët, e paarritshme, një nënë që nuk do të pranonte kurrë të zbriste deri tek e bija. Asnjë fjalë nga ato që kishte menduar nuk mundej t'ia thoshte.

Rastet kur i vidhej përgjimit të nënës dhe mbërrinte me sukses teshtirati i vëllait të vogël e ngazëllenin. Që nga çasti që hapte derën e jashtme, kalimi nëpër terr në korridor, e deri te mbyllja në dhomën e saj, ku flinte me të motrën, vëllanë dhe gjyshen, ishte një jetë e tërë gjithë frikë. Futej në shtratin e nxehtë, plekste këmbët e mërdhira me ato të të vëllait, që trembej në gjumë dhe, posa vinte kokën në jastëk, flinte si qengj. Papritmas zgjohej nga duart e nënës, që e kërkonin nëpër terr. Pasi ia prekte flokët dhe bindej se e bija ishte kthyer, ajo qetësohej. E mbulonte dhe e përkëdhelte me dhembshuri. «Prapë këtu ka fjetur, marrokja.»

— Lëre vajzën të lirë tani, lëre të bëjë jetën e vet, — dëgjonte gjyshen t'i fliste nënës me zë të ulët. Gjyshja dinte të shihte e të mos fliste. — I harrove të tuat? Ti më ike me një partizan fshehurazi, sapo zbritët nga mali!

Nëna psherëtinte. — Eh, ua kam merakun, janë tepër të rinj. Ajo tetëmbëdhjetë, po edhe ai, as njëzet. Pastaj, sikur është bërë tjetërsoj, s'është ajo që ka qenë, s'e mban mendjen në asnjë vend.

— Ti ke qenë më keq, moj bijë, janë trillet